



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 60107

Më: 19 maj 2025

Në bazë të nenit 52 paragrafit 1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 59 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërras Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet me **27 maj 2025 (e martë)** në sallën për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **orën 10:00**. Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 25 mars 2025
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores për Varrimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave të reja të Prizrenit në Landovicë.
6. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025;



Kryesuesja e KPF-së
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

SKUPŠTINA OPŠTINE PRIZREN

Komitet za Politiku i Finansije

Br. 001/060 – 60107

Dana: 19 maja 2025

Na osnovu člana 52 stav 1, Zakona o Lokalnoj Samoupravi i člana 59 stav 1 Statuta opštine Prizren, br. 01/011-5643, dt. 15.10.2008. sazivam sastanak Komiteta za Politiku i Finansije koja će se održati **27 maja 2025 (utorak)** u sali za sastanke KPF-a, u „Beloj kući“, sa početkom od **10:00 časova**.

Stoga ste pozvani da učestvujete u radu ovog sastanka kao član Komiteta za Politiku i Finansije, pridržavajući se predviđenog vremena, datuma i mjesta.

Za rad ovog sastanka predlažem sljedeći:

DNEVNI RED

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika od: 25 marta 2025;
2. Razmatranje i usvajanje dnevnog reda;
3. Razmatranje i usvajanje prethodne predlog-odluke o davanju opštinske imovine na kratkoročno korišćenje organizacijama civilnog društva;
4. Razmatranje i usvajanje predloga odluke o formiranju Komisije za procenjivanje;
5. Razmatranje i usvajanje Projekt-Pravilnika za sahranjivanje i održavanje novog groblja u Prizrenu u Landovici;
6. Finansijski izveštaj za period januar-mart 2025. godine.



Predsedavajuća KPF-je
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PRIZREN BELEDİYE MECLİSİ

Siyasi ve Maliye Komitesi

No. 001/060 – 60107

Tarih: 19 Mayıs 2025

Prizren

03/L - 040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un 52. Maddesi ve 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 59. Maddesi, 1. Fıkrası gereğince, **27 Mayıs 2025** tarihinde (**Çarşamba günü**) saat **10:00** da "Beyaz Evde" SMK oturum salonunda düzenlenecek olan Siyasi ve Maliye Komitesinin toplantısını çağırıyorum. Bu yüzden, toplantının belirlendiği tarih, saat ve yere bağlı kalarak Siyasi ve Maliye Komitesi üyesi niteliğinde toplantının çalışmalarına katılmak üzere davet ediliyorsunuz.

İşbu toplantı için şu gündem noktaları belirlenmiştir:

GÜNDEMİ

öneriyorum

1. 25 Mart 2025 tarihindeki oturum tutanağın görüşülmesi ve kabul edilmesi;
2. Gündemin görüşülmesi ve kabul edilmesi;
3. Belediye taşınmazlarının Sivil Toplum Örgütlerine kısa süreli kullanımına ilişkin ön teklif-öneri kararın görüşülmesi ve kabul edilmesi;
4. Değerlendirme Komisyonunun kurulmasına ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve kabul edilmesi;
5. Prizren'in Landovica'daki yeni mezarlığın defin ve bakımına ilişkin yönetmelik taslağının görüşülmesi ve kabul edilmesi;
6. Ocak-Mart 2025 dönemi Maliye Raporu.



SMK Başkanı
Antigona Bytyqi

Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 32909

Më: 25 mars 2025

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 25 mars 2025 në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:08 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Adem Shabanaj, Naxhije Memaj Florent Ukaj, Egzona Hoxhaj dhe Bajram Kastrati, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mungoi: Dafina Alishani dhe Levent Buş.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Kujtim Gashi - Nënkyetar i Komunës, Luljela Veselaj Gutaj – Drejtoreshë e DKA-së, Ymer Berisha nga Zyra për Komunikim me Publikun, Halil Lika nga DEF, Urim Dakaj dhe Fahri Krasniqi nga Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Islam Thaqi – Kryesues i Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përfaqësuesi i OSBE si dhe OJQ-të e Mediat.

Antigona Bytyqi: Atëherë a jemi gati me filluar meqë jemi pesë anëtarë dhe dy veç sa s'kanë mbri? Kështu që po ju përshëndes të gjithëve të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, shumë i nderuar nënkryetar, zyrtarë, drejtorë, media, të gjithë të pranishëm. Për sot kemi thirrë mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent jemi pesë anëtarë, kështu që kemi kuorum për të vazhduar punimet, dhe rendi i ditës për këtë mbledhje është ky:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 25 shkurt 2025;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-strategjisë për sigurinë në institucionet arsimore në komunën e Prizrenit;
4. Raporti financiar për periudhën janar dhjetor 2024;
5. Raporti i komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, për analizimin e dëmeve të shkaktuara nga fishekzjarrët në fundvit;
6. Raporti i punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2024.

Po fillojmë pa humbur kohë me pikën e parë.

Pika e parë:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 25 shkurt 2025.

Antigona Bytyqi: Nëse keni diçka me shtuar ndonjë koment, ndonjë vërejtje diçka? Në qoftë se jo po e hedhi në votim. Prezent jemi pesë anëtarë, kush është për që miratohet? Unanimisht ju faleminderit. Kalojmë te pika e dytë.

Pika e dytë

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Antigona Bytyqi: A keni diçka me shtuar rreth rendit të ditës? Në qoftë se jo po e hedhi në votim, pesë anëtarë jemi prezent. Kush është për që të miratohet rendi i ditës? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e tretë.

Pika e tretë;

Shqyrtimi dhe miratimi projekt-rregullores për transparencë në komunën e Prizrenit;

Antigona Bytyqi: Fjalën ja kalojmë zotëri Ymer Berisha.

Ymer Berisha: Kryesuese faleminderit, Përsëndetje për të gjithë, Nënkyetar poashtu. Unë mbaj komunën aktive që dokumentet të jenë korrekt ligjërisht, niveli qeveritar ka fuzionuar tre udhëzime administrative nën një, tash është duke i pretenduar që komuna t'i emërtojë komunat e hapura, në mënyrë që audiencat sa më të mëdha të jenë të involvuara në proceset vendimmarrëse edhe ky ndryshim i këtyre tri udhëzimeve administrative detyron pastaj këto produktet vartëse të tyre çfarë është rregullorja dhe strategjitë e planet krejt të ndryshojnë. Kështu që e kemi detyrim nga niveli qëndror që komunat e Kosovës të ndryshojnë rregulloret e tyre të transparencës dhe ne e kemi bërë këtë rdraftin që e keni dhe ju në mbajtje, Mendojmë që drafti është profesionalisht mirë edhe i ezauruar nga të gjitha komunat për arsye se kemi një kolegim atje që unë jam një farë kryetari i kolegiumit atje të zyreve për komunikimin publikun, kështu që besoj që është dokument i cili i plotëson kërkesat e qytetarëve, por i plotëson edhe mundësitë e komunës sepse kemi mund me e ruajt këtë autoritet, jo me futur një produkt që ndoshta është i dëshirueshëm për një palë, por pala tjetër është e pamundur me e zbatuar, kështu që e kemi ruajt në nivel. Pastaj kemi edhe një ndryshim, meqë USAID ka kërkuar, tash a mbyll, po mbeti kjo në legjislacionin tonë, është ky buxhetimi me pjesëmarrjen të qytetarëve, tash ka kaluar në rregullore në nivel, e ka përvetësuar qeveria e Kosovës edhe e ka bërë rregullore të vetën edhe tashmë në rregulloren për transparencë ku përveç takimeve publike, konsultimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore që e kemi pas në të kaluarën, tash e kemi edhe buxhetimin me pjesëmarrje, kur paratë e taksapaguesve të komunës së Prizrenit do të duhet të shkojnë përmes këtij protokolli. Ka qenë iniciativë e USAID-it, po tash Qeveria e Kosovës e ka përvetësuar si praktikë të mirë edhe i ka dhënë drejtim ligjor. Kështu që domethënë aspektet kryesore janë këto, ato tre udhëzimet që kanë ndryshuar janë fusionu nën një që duhet të rregullorja t'i përmbajë, takimet publike që të ketë edhe dëgjime buxhetore me pjesëmarrjen meqë ka shpenzime të parësë publike, edhe një që ka ndryshuar është se Qeveria e Kosovës e ka parë kërkesat e komunës si duket janë shumë edhe nuk ka mundur me bë shqyrtime për 15 ditë, neni i fundit i rregullores thotë tash ligjshmëria, Blerimi nëse është këtu ose këta zyrtarët e juaj Kryesuese tash ministritë kanë kohë ligjore 30 ditë nga 15 ditë për konfirmim ligjor, tash komuna duhet me planifiku që nuk vjen, nuk kthehet dokumenti për 15 ditë, por për 30 ditë, tek pas 30 ditëve mund të hyj në fuqi në atë automatizmin administrative. Domethënë edhe këtu është ndryshim ligjor, kur shkojnë për konfirmim nga komunat atje, ministria deri para një muaji ka pasur 15 ditë kthimin të detyruar ligjërisht, tash e ka përshtat ligjin për udhëzim administrativ dhe e ka bërë 30 ditë. Kështu që ne kemi me 30 ditë, po kur planifikoni ndonjëherë dokumentet mos pritni që kthehen për 15 por për 30 e më shumë. Këto janë ndryshimet.

Antigona Bytyqi: Faleminderit zotëri Berisha. A keni diçka me pyet? Po ja kaloj fjalën anëtarëve.

Karanfil Haxhillari: Përshëndetje. Ok, në bazë të kësaj që u tha domethënë deri tani është që vetëm është plotësuar dhe është fusionu udhëzimet administrative të ministrisë, ndonjë gjë tjetër nga ajo e mëhershme sepse kemi votuar më herët në një rregullore për transparence. Vetëm kjo është përmirësuar me ato udhëzim. me administrative që kanë ardhë prej ministrisë, ndonjë ndryshim më thelësor naj sen nuk ka, ajo është të cilën edhe e kemi votuar më herët, përveç ndryshimeve këtu në përputhshmëri me udhëzimet administrative të cilat kanë qenë.

Ymer Berisha: Këto triat janë kryesore, konfirmimin ligjor, komunat nuk duhet me pritë edhe ju si kuvend tash se ju keni vendime, kur i çojnë për ministri mbas 15 ditë keni mund me e zbatuar, tash jo, duhet me per 30, që është ndryshim esencial. emërtimi i takimeve publike që i bënë kryetari, konsultimet publike kur hartohen dokumentet, dëgjimet buxhetore kur del me hartuar buxhetin, tash ja kanë shtu buxhetimin me pjesëmarrje, por duhet të hyjë në dokument tash edhe ky emërtim se po shpenzohet paraja publike e secilës komunë, tash sa e përcakton kjo është diskresion i kryetarit pastaj sa pare don me shku në këtë protokoll. Edhe nga këto tre udhëzime e kanë bërë, e kanë fuzionuar Qeveria e Kosovës udhëzimin për komunat e hapura, ka qenë për konsultime me pjesëmarrje minimale domethënë të audiencave publike, janë këto tre esenciale, të tjerat ruhen. Domethënë kur njoftimet duhet me u bërë me kohë, lajmërimet me kohë, audiencat me kohë, jemi të hapur për shpenzimin e parasë publike ose të resurseve njerëzore. Tash në këtë dokumentin që e kemi hartuar, unë besoj që jam munduar me dhënë krejt veten time atje se edhe të grupit se jo kështu. Mendoj që është një dokument reprezentativ, nëse e shtijmë në garë me komuna të tjera dalim pak më mirë për shkak të gjuhës, kjo të ju them se edhe juristët kur i hartojnë në nivel të Kosovës e kanë atë gjuhën juridike. Unë tani po e socializoj pak edhe me këtu, ka ndryshime nga komunat të tjera, tre komuna të tjera të mëdha të Kosovës ma kanë kërkuar si draft të Prizrenit me pas që ju kam dhënë, ka mundësi me dalë kjo e jona miratohet e para, por edhe janë edhe dy komuna të tjera për shkak të lojalitetit kolegjial, por diçka të veçantë tjetër s'ka. Ndalesë nuk ka, qytetarët duhet të marrin pjesë në të gjitha proceset vendimmarrëse të komunës së cilësdo komunë, tash sa marrin pjesë është diskrecioni i tyre, lajmërimet, njoftimet duhet me kohë ligjore, jo me kohë sa ne duam, domethënë 7 ditë, 15 ditë përpara, të pranohen materialet, të bëhen ato dhe aty janë brenda asaj rregullore, edhe e folura, fjalori e ka një frymë promovuese, domethënë kur ju jep mundësi thotë burra edhe gra kush din me ja qëllu. Kështu jemi të hapur, marrim vendime për arsim, për shëndetësi, madje edhe për ato institucionet që i kemi në varësi, këto institucionet publike që janë Eko-regjioni e të tjera. Domethënë të gjitha janë të obliguara me dokument, stacioni i autobusave tash që është përvertësuar nga komuna, është me dokument. Domethënë jemi goxha korrekt në shkrimin e kësaj, por ndonjë ndryshim esencial tjetër s'ka, vetëm që 15 në 30.

Antigona Bytyqi: Dikush tjetër a ke ndonjë pyetje? Në qoftë se jo, atëherë po e hedhim në votim që t'i rekomandohet mbledhjes që do të mbahet ditën e enjte. Prezent jemi shtatë anëtarë, kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Unianisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e katërt.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-strategjisë për sigurinë në institucionet arsimore në komunën e Prizrenit,

Antigona Bytyqi: Drejtoreshë, fjala përjuve.

Luljeta Veselaj Gutaj: Faleminderit Kryesuese. I nderuar Nënkyetar, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, media, të pranishëm. Strategjia për Sigurinë e Institucionet edukativo-arsimore për komunën e Prizrenit, synon të parandalojë rreziqet të cilat i minimizojnë incidentet dhe promovojnë një kulturë të mirëqenies në shkollë. Siguria e shkollës e përfshin një gamë të gjerë të kategorive që përqëndrohen në një mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm për nxënësit dhe mësimdhënësit. Drejtoria Komunale e Arsimit ka ndarë këto kategori që lidhen në çështjen e sigurisë të shkollave në komunë, ndërsa për secilën kategori ka planifikuar të merren edhe masa dhe aktivitete të cilat çojnë drejt një mjedisi të sigurtë shkollor. Strategjia është punuar me një grup të gjërë të njerëzve në bashkëpunim edhe duke parë, duke bërë një analizë nga rrethanat dhe gjendja në cilën aktualisht problemet që ballafaqohen në shkolla. Në secilën masë dhe në secilën kategori që janë aktivitetet edhe masat për të cilat besoj që ju dokumentin e keni pasur në kohë, e keni lexuar, e keni analizuar. Për mos me ju marrë shumë kohë unë po pres pyetje, propozime dhe sugjerimet e juaja. Strategjia ka kaluar të gjithë hapat të cilat duhet të vijnë deri në votim në kuvend.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtoreshë. Po ja kaloj fjalën anëtarëve.

Kujtim Gashi: A bënë Kryesuese veç për Ymerin e jo për drejtoreshën. Te kjo 15 ditë në 30 ditë, a keni harmonizuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, se ligji për Vetëqeverisje Lokale përcakton 15 ditë, këtu ka kohezion në këtë rast!

Ymer Berisha: Po por problemi është në nivel qëndror e jo në lokal.

Kujtim Gashi: Po po e qartë, veç për shembull kryesuesja edhe kryetari i komunës i referohen këtij ligji, se e kanë ligj më bazik për me qeverisë komunën, ndërkohë tash ka ardhur tash me një ligj tjetër ku thotë 30 ditë! A këtu e kemi saktë na 15 ditë, ky ligj nuk ndryshon, dihet arsyet pse s'ndryshon se është ligj vital. Unë besoj që këtu ka domethënë kundërshtime, tash qeveria mund me luft me 30 ditëshin, komuna mund me luft me 15 ditëshin.

Antigona Bytyqi: Kundërshtime ka pasur edhe prej kolegjuumit të Kryesuesve por s'kanë marrë parasysh, ne kemi qenë shumë kundër.

Kujtim Gashi: Përndryshe çdo rast që shkon deri në gjykatë komuna secilin e fiton këtu.

Ymer Berisha: Tani si ne jemi në diskutim, domethënë edhe ditën kur mbahet, nëse mendon që komuna e Prizrenit, e kam problem që kur ta çoj për konfirmim ligjor ata mund me ma kthi që nuk është në përputje me këtë.

Kujtim Gashi: Jo veç thashë që a e keni diskutuar?

Ymer Berisha: Me diskutuar e kemi diskutuar, po ata e kanë një departament Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, një zyrës ligjore të tyre edhe tani ne thjesht i subordinohemi, krejt çka mujmë me bë është kjo. Ne e kemi cekur në Rregullore Ligjin për Vetëqeverisje Lokale si një lloj kushtetute për komunat e Kosovës, I kemi thënë atyre zyrtarëve ligjorë, po ata e kanë marrë përsipër edhe ka ndodhur jo më larg sesa para janë 27-28 ditë,

Antigona Bytyqi: Po po shumë shpejtë e kanë dërguar.

Ymer Berisha: E paskan dërguar edhe tek Kryesuesja, unë nuk e kam ditë këtë, domethënë brenda brenda këtij muaji ka ndodhur ky ndryshim. Këtu ka ndodhur një problem, Drenasi e ka miratuar rregulloren me 15 ditë, mbas tre katër ditëve që e kanë miratuar ata u bërë ky ndryshim, tani ka shkuar shkresa me e çu në kuvend prapë se nuk është në përputhje me ligjin. Qe ç'ka ndodhur, a i njëjti material në shkrim është, thash vetëm e kam modifikuar si shkrim, por përmbajtja është e njëjta. Por qe tash, nëse ndryshon një presje në një ligj, këto produktet vartëse duhet t'i nënshtrohen protokollit të njëjtë. Thash edhe një komunë tjetër që janë aty unë thashë në kolegji detyrohen apet kuvendarët e tyre të tjerët veç për shtak ku e kanë pasur 15 duhet me bë 30 këtë numër, për në kuvend me u votu.

Kujtim Gashi: Në rregull.

Antigona Bytyqi: Po kthehemi përsëri tek drejtoresha, fjala ke tek anëtarët e komitetit. Në qoftëse ka dikush ndonjë pyetje ose ndonjë çështje rreth kësaj pike?

Karanfil Haxhillari: Pyetjet i bëjmë në kuvend, me thënë të drejtën nuk e kam lexuar në detaje këtë projekt-strategji. Edhe pse ka shumë pyetje. Veç një nën pyetje, a do të vazhdojë pagesa e sigurimeve? Meqënëse edhe kjo hyn në atë aspektin e sigurisë së shkollave, edhe pagesat private të prindërve për sigurimet? Tash a janë private apo publike, qysh janë të organizuar ato sigurime nëpër shkolla, nuk e di, me thënë të drejtën. Por a e keni mendu një zgjidhje afatgjatë, më të qëndrueshme që të ndodhë në shkolla në të ardhmen?

Luljeta Veselaj Gutaj: Po faleminderit Kranfil. Siguria fizike, aktualisht në shkolla nuk ka siguri fizike në kuptimin e sigurimit fizik që rrinë në shkolla. Kanë shkollat vetëm aty ku këshillet drejtuese të shkollave ku përbëhen edhe prej prindërve, vendosin në bazë të gjendjes së rrezikshmërisë ose nivelit ku gjendet shkolla edhe participojnë prindërit. Ato varen nga organizimi i brendshëm i shkollës, jo nga DKA-ja dhe komuna. Mbrenda kësaj rregullore janë paraparë të gjitha masat edhe aktivitetet të cilat të krijojnë një ambient të sigurtë brenda institucioneve shkollore, që nënkupton qoftë me fushatat vetëdisuese, qoftë me forma të tjera të aktiviteteve në bashkëpunim edhe me drejtoritë e tjera. Se këtu një rol të rëndësishëm i luan edhe inspektoriat, i luan edhe shërbimet publike, luan edhe emergjenca dhe organizata të ndryshme qeveritare të cilat ndihmojnë dhe shërbejnë. Çfarëdo propozimi, kjo ka qenë në diskutim publik, kemi mbajtur edhe takime dhe ka pas edhe komente dhe në takim, kjo është situata. Këto janë përmbajtja e strategjisë, në të ardhmen e afërt ishalla buxheti i komunës është më i lartë edhe siguri fizik nëpër shkolla, dëshira ime është mos me pas siguri fizik, por shkolla me pa një ambient edukues i dashur dhe shoqnia jonë me pa si shkollë, si ambient i shkollës me ruajt si vlerë, jo me dëmtu edhe me bë dëm.

Bajram Kastrati: Sipas jush a ka nevojë drejtoreshë?

Luljeta Veselaj Gutaj: Po ka nevojë, në disa shkolla ka nevojë varësisht ku gjendet shkolla dhe çfarë komuniteti e rrethon.

Kujtim Gashi: Përderisa ka në Amerikë, besoj ka nevojë edhe te na.

Bajram Kastrati: Cila është kostoja e asajna që duhet me u fut në buxhet për afërsisht ?

Luljeta Veselaj Gutaj: Varësisht sa objekte shkollore, sa persona

Bajram Kastrati: Në përgjithësi në të gjitha shkollat për shembull, a është naj projekt për të gjitha shkollat.

Luljeta Veselaj Gutaj: Po zakonisht preferohet te shkollat ku varet thash prej komunitetit, çfarë komuniteti e rrethon edhe aspekti i gjendjes së sigurisë që është në ambientin rreth shkollës. Për shembull nëpër shumicën e fshatrave s'besoj as që ka nevojë as rrethoja me qit sepse niveli për me ruajt shkollën ose ambientin komunitetit që është i përbashkët asnjëherë s'ndodh asnjë dritare me u thy ose asnjë derë. Por kena shkolla edhe midis qytetit që përpik qejfit i teket dikujt gjuan dhe e then një dritare, katër dritare na i kanë thy në Lekë Dukagjin brenda tre ditëve pa pikë nevojë a e din? Veç pse po du me bë një dam në shkollë kjo është! Unë mendoj, që thashë dëshira ime është mos me pas sigurime fizike, po shkolla me u pa një ambient që ne secili prej nesh duhet me ruajt edhe me siguru. A ndodhë a ajo, ndoshta duhet kohë goxha shumë për me ndryshuar, po që e tha edhe nënkryetari në vende të ndryshme të botës ndodhin.

Karanfil Haxhillari: Në vende të ndryshme a din zakonisht bëhen memorandume bashkëpunimi me policinë të cilët edhe e krijojnë një fushatë vetëdijësuese që fëmijët me pas qasjen më ndryshe ndaj policëve e jo me e pa sikur ndonjë armik a din për me u kanë më bashkëveprues me policinë. Poashtu edhe mbajnë mend në itali zakonisht, patrolat e policëve kryesisht të karpullojnë më shpesh ku janë shkollat duke eliminuar pastaj këto sigurimet fizike, çka po di unë. Por si do që të jetë kjo prap...

Luljeta Veselaj Gutaj: Një çështje shumë kruciale, për këto tre vite kemi bashkëpunim të jashtëzakonshëm me Policinë e Kosovës dhe shumë falenderuese për krejt punën që e bëjnë edhe në afërsi të shkollave edhe me situata kur duhet me reagu në shpejtësi, po edhe në fushatat vetdisuese. Policia e Kosovës në Prizren ka pas aktivitete edhe që i ka marrë fëmijët i ka vesh si polic edhe i ka nxjerrë në grup se si duhet me respektuar komunikacionin, si të ndalojmë një veturë kur bën tejkalime të rregullave e të tjerë e të tjerë. Jë bashkëpunim i jashtëzakonshëm dhe unë i falenderoj. E konsideroj që një situatë stabile edhe ata janë një prej faktorëve që e kemi në Prizren. Por a duhet me u ndal, nuk guxojmë mu ndal edhe gjithmonë duhet me bë edhe më tepër për me u bë edhe më mire.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. Nëse s'keni edhe dikush tjetër diçka, po e hedhi në votim edhe pikën e katërt që t'i rekomandohet mbledhjes. Prezent jemi shtatë anëtarë, kush është për? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e pestë.

Pika e pestë:

Raporti financiar për periudhën janar-dhjetor 2024;

Antigona Bytyqi: Zotër Halil, fjala për juve.

Halil Lika: Faleminderit zonja Kryesuese. Të hyrat të përgjithshme të buxhetit komunal për 2024 te granti qeveritar është 55 milion dhe të hyrat vetanake janë planifikuar 10 milion, totali është 65, po buxheti me ndryshime është totali, domethënë kemi pas të hyra vetanake 3 milion e 270 mijë shtesë dhe totali është 71 milion. Shpenzimet janar-dhjetor janë 68 milion e 794 mijë dhe buxheti i pashpenzoar është 2 milion e 653 mijë, faktikisht 96.29% është shpenzuar buxheti. Të hyra vetanake është totali 10 milion e 193 mijë, realizimi është 10 milion e 446 mijë, pra është 2.5% më shumë i realizuar. Mund të cekim domethënë sipas drejtorive nëse është nevoja. Kapitallet janë. 25 milion e 816 mijë, realizimi është 23 milion e 823 mijë, me përqindjen 92.28%. Nëse keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Antigona Bytyqi: A keni pyetje diçka?

Bajram Kastrati: Pagesat për lehonat a u kryjtën? Kemi pasë shumë thirrje.

Egzona Hoxhaj: Jo në fakt mu tash më shkruajti dikush më veti.

Halil Lika: Në qoftë se ka ndodhur ndonjë gabim në llogari po ndodh të kthehet, përndryshe shumica janë kryer, por në qoftë se ka, një koleg që po merret mund të ves edhe njëherë.

Bajram Kastrati: A janë nda në dy grupe apo jeni kryer në përgjithësi kërkesat?

Halil Lika: Në përgjithësi janë kry kërkesat, vetëm kanë mbetë me gabime teknike të kontove për kontove, se ndryshe nuk ka tjera.

Karanfil Haxhillari: Sa është borxhi i komunës ndaj operatorëve ekonomik deri tash? Nuk i mora këto shënimet, tash janë 50 faqe edhe mirë është domethënë në seancë të bëni pyetje dhe besoj që do të jep përgjigje drejtori apo kush merr pjesë.

Antigona Bytyqi: E keni pas pyetje edhe në seancën e kalume, plus ja u kam dërguar me e-mail.

Kujtim Gashi: S'ka me pas përgjigje kurrë sepse ajo është proces që lëviz borxhi gjithmonë ato janë vetëm kontrata kornizë tre vjeçare, kështu që s'ke me dit me nxjerrë këtë rezultat sepse sot e nxjerr nesër të luan.

Antigona Bytyqi: A keni pyetje të tjera?

Kranfil Haxhillari: Po veç edhe borxhhet mbesin kur planifikimin se ke të saktë, domethënë i zgjat këmbët më shumë se që e ke jorganin.

Halil Lika: Tash ka ndryshime në SIMFK që nuk lejon. tash duhet sipas planifikimit mundesh me bë domethënë edhe kontratën nuk tejkalohet.

Karanfil Haxhillari: Tash realizimi, kur ta mendosh dhe ta bësh një krahasim buxheti është realizuar 95% qysh u cek, në anën tjetër ke borxhe me miliona a e din, diqysh s'po më përphet kjo! Qysh u realize, si u realizu a në qoftë. se janë borxhe a i bjen që është bë ban maki 200% u realizuar ky buxhet në këtë logjik.

Bajram Kastrati: Marrëveshja me operatorin që...

Halil Lika: E ka kontratën kornizë që mundet me e cek po është puna që tash edhe ministria e planifikon ato mjete të planifikosh edhe t'i bllokun dhe nuk mund të bësh projekte të reja sikur përpara qysh ka qenë, domethënë do të jetë pak më ndryshe sistemi edhe për çështjen më ndryshe.

Kranfil Haxhillari: Gjithmonë më ndryshe, gjithmonë ka arsyetim.

Halil Lika: Jo synohet edhe sipas domethënë planifikimit të bëhet edhe prokurimi edhe do të jetë në sistem ashtu që domethënë s'ka me pas ndryshim.

Kujtim Gashi: Edhe kallëzoji që ka me kanë tash suficit miliona nëpër komuna.

Halil Lika: Ka mundësi shumë.

Adem Shabanaj: Edhe unë diçka deshta me shtuar Kryesuese. Përsëritje për të gjithë, sa i përket përqindjes totale të shpenzimit të buxhetit, a është e futur edhe ajo e përmbaruesve edhe sa ka qenë vlera, kostoja e cila i ka kushtuar komunës së Prizrenit në përmbarim? Cila ka qenë kosto?

Halil Lika: Këtu nuk e kam por ndoshta edhe në lajme e keni lexuar që ka qenë diku 5.5 milion.

Kujtim Gashi: Duke përfshi edhe kontratën kolektive.

Halil Lika: Po, se është ndikim i madh arsimit që është tuj

Adem Shabanaj: Pikërisht këto ndryshime që po bëhen, po na detyrojnë edhe si komunë me e qu në përmbarim, po të detyrojnë me një farë forme se operatorin ekonomik nuk mundesh me, si me thënë nuk mundesh me e mbajt në nivel të pagesave pa e dërguar në përmbarim.

Kujtim Gashi: Sivjet ka me kanë numër i madh i përmbaruesve.

Adem Shabanaj: Ka me kanë apo s'ka me kanë?

Kujtim Gashi: Ka me qenë besoj për shkak të këtyre fakturave që po regjistrohen.

Adem Shabanaj: Edhe kjo është një fakt shumë i keq edhe unë mendoj që drejtori sot është dashur me qenë këtu edhe me diskutu, që me diskutu edhe me Ministrinë e Financave.

Halil Lika: Shkoj në Prishtinë se kish ardhë me siguri, por pati një punë që është dashur të shkon.

Adem Shabanaj: Por sidoqoftë, besoj që është në seancë dhe mundemi me diskutu.

Halil Lika: Po, në seancë do të jetë, mundeni me diskutu.

Adem Shabanaj: Faleminderit.

Antigona Bytyqi: Dikush tjetër? Në qoftë se jo atëherë po e hedhim në votim që t'i rekomandohet mbledhjes. Prezent jemi shtatë anëtarë, kush është për? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e gjashtë.

Pika e gjashtë:

Raporti i komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera për analizimin e dëmeve të shkaktuara nga fishekzjarret në fundvit.

Antigona Bytyqi: Po zotëi Urim apo Fahri cili doni me prezantu s'e di.

Anëtari i Komisionit: Përsëritje Kryesuese, përsëritje Nënkytar dhe juve kuvendar. Ne si komision, kemi prit kërkesat e qytetarëve, diku në tetë ditë është afati ligjor, kryetari ka gabuar shtatë ditë se qashtu e kanë inform, por tetë është. Pas tetë ditësh ne kemi dalë në terren, kemi bërë verifikimin për secilën ku ka katër kategori të ndame: në biznese, në ekonomi familjare, në banesa

kolektive edhe në vetura po e them unë. Kemi pas pak telashe për situatën e çmimeve sepse ka pasë llojllojshmëri të gjamave të këtyre dritareve, ne kena pas problem edhe me automjete, koston sa me qitë, qekjo na ka marrë pak kohë se kena shku nëpër biznese, kena marrë oferta të çmimeve se sa. Kena ardh në përfundim që secili e kemi raportin që ka dalë vlera përfundimtare 84 mijë e 238 euro e 79 cent. Kur kemi dorëzu dhe ka për secilin raport, për secilin rast veç e veç është raporti për secilin.

Antigona Bytyqi: Ju faleminderit, edhe një material na keni dërgu. Dikush a dëshiron me marrë fjalën rreth kësaj pike, në qoftë se keni ndonjë pyetje diçka? Po Adem urdhëro.

Adem Shabanaj: Jo pyetje jo, veç në bazë të raportit që e kemi lexu pak a shumë, po besoj që keni bërë një punë jashtëzakonisht të mirë, sa i përket vlerësimit edhe raportit të asaj që ka ndodhur aty. Nuk e keni pasur të lehtë sepse ju, duhet t'ju kuptojmë që edhe rasti ka qenë shumë i rëndë edhe ka ndodhur në kohën edhe të festave edhe kemi pasur një tragjedi me një jetë të humbur edhe nuk është kanë e lehtë me u marrë me dëmet materiale kur e kemi pasur një jetë të humbur në atë ngjarje. E vetmja shpresë që po, tash duke i lënë gjithë ato peripeci të cilat keni kaluar, po besoj që kanë me e pas parasysh edhe komuna edhe kuvendi edhe drejtoria përkatëse për vlerësimin edhe për pagesën e këtyre dëmeve të cilat janë shkaktuar edhe ato materiale të cilat kanë qenë aty. Nuk e di tek familja në Zhur a është paraparë në vlerën e këtij raporti që të subvencionohet edhe familja e të ndjerit të fshatit Zhur sepse nuk dimë si ta kategorizojmë rastin e të ndjerit. Mirëpo a është paraparë në këtë raport dhe në këtë vlerësim edhe subvencionimi i familjes së të ndjerit? faleminderit.

Anëtari i Komisionit: Jo, ne si komision e kena bë një kërkesë të veçantë, nuk u përfshi ky, po si komision e kemi paraparë që ka nevojë edhe me nda një shumë varësisht prej kryetarit, nuk guxojna na me shti për familjen, veç kryetari e ka në drejtën, ne e kemi pasur si kërkesë edhe në e-mail që ja kemi dërgu edhe Kryesueses, kërkesa jonë është që me e ndihmu edhe atë familje sepse më së shumti ajo ka pësu.

Karanfil Haxhillari: Po i bashkangjitem Ademit, vetëm këtu ku i kemi vlerat zero a e din që s'ka vlerë zero, në raport veç hiqeni edhe një për mos me pas keqkuptime të nesërmen, këshilli i banesave a e din koka i dëmtum diku me 804€. Qysh mundemi me kuptu qeta këshilli i banesave? është kategoria e parafundit.

Anëtari i Komisionit: është koridor, është hapësira publike, hymjet e përbashkëta.

Karanfil Haxhillari: A e din që me e pasë më të qartë.

Anëtari i Komisionit: Këto që janë me zero është kjo EURO-FOOD, e ka bërë një kërkesë edhe kur kena shkuar nan ë vend të ngjarjes, çfarë dëmi ke? agregati pesë me dy a sa është, tha mu ka prish prej fishekzjarreve, unë i thashë merre ti një raport prej mekanikut që e konstaton që dëmi ka ardhë prej fishekzjarrit bjerma me vulë edhe në shtimë, ai s'ka pru kurgjo edhe jena në rregull. Është një Qadraku më duket një femën, është lokali ky rasti i pesë që është Enis Dana që është në lokal të saj me qira, e kanë bë të njëjtën, për atë është me zero.

Karanfil Haxhillari: Ok edhe tash, sepse puna e subvencionimit të familjes. Unë konsideroj që duhet të bëhet nga ana e kryetarit po edhe kisha kërku që me të vërtetë, sepse kur është trajtu kjo temë unë jam nd shumë keq. Unë e kam njoftë edhe personalisht Monin, ndjes pastë edhe diqysh angazhimi jonë për ndihmë të bizneseve në raport me humbjen e një jete është për mua është i

pakrahasueshëm dhe i pavlefshëm në tanësi. Por meqënëse tash kaloi një kohë a din dhe insistuam ne ata që të kompensohen, mirëpo unë e kisha thënë që me të vërtetë në qoftë se së paku nuk i ndihmojmë edhe familjes në këtë raport, si komunë apo si kuvend nuk kemi bërë kurrëgjë. Prandaj krahas kësaj që ok nuk ka ndonjë vlerë ku me dit sa që mundemi ndoshta pak a shumë edhe me e zbutë a e din, jo në cent në cent me ja u pagu këtyre se në fund të ditës një xham apo një dyqan nuk krahasohet me një biznes, nuk krahasohet me jetën e njeriut, por që në qoftë se e lëmë edhe familjen pa një subvencion atëherë nuk kemi bërë dhe nuk është drejtësi a din nga ana e kuvendit në këtë rast. Kështu që Kryesuese unë të lus a din, po shpresoj që më bashkangjiten edhe antarët e tjerë të KPF-së që ta bëni një kërkesë edhe te kryetari që në këtë pikë të rendit të ditës pasnesër të futet edhe një subvencionim për familjen e të ndjerit.

Islam Thaqi: Po veç duhet me titullu atë, me fal që ndërhyta se s'jam anëtar i Komitetit.

Karanfil Haxhillari: Po tash meqënëse nuk e kemi si material, po mendoj dy ditë i kanë kohë le ta gjejnë formën, mënyrën. Kemi raste të tilla ku kryetari e ka të drejtë për subvencionim, i ka ato farë limitet maksimumet, minimumet për subvencionim, edhe që edhe në kërshi të qytetarëve kishim dalë shumë më korrekt, shumë më drejtë se vetëm këto biznese në qoftë se i kishim subvencionu unë për vete ban vaki, në qoftë se veç këto biznese s'kam shpirt me e ngritë dorën veç për këto.

Antigona Bytyqi: Na u dakorduam atë ditë me ardhë vetëm me raportu Komisioni, a keni marrë ndonjë përgjigje prej kërkesës që e keni bërë te kryetari për këtë familjen?

Anëtar i Komisionit: Jo.

Antigona Bytyqi: Po Florent Urdhëro.

Florent Ukaj: Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Edhe unë i bashkëngjitem kërkesës së Karanfilit, madje mendoj që na nuk duhet me bërë asnjë votim, jo që jemi kundër bizneseve apo diçka, absolut duhet me u subvencionu edhe bizneset sepse nuk kanë pasur faj ata, ka ndodhë një tragjedi pa fajin e atyre. Ne më së pari duhet me subvencionu familjen, tani me vazhdu me biznese. Edhe te komisioni, ju përgëzoj për punën që e keni bërë, por ne e dimë që shumë herë këtu, besoj i njëjti komision, veç ka pas disa ndryshime edhe nga ana e bujqësisë, kemi bërë raporte, kemi bërë vlerësime, edhe e dimë që nuk ka kurrëfarë pagese ose nuk ka kurrëfarë mbështetje për ato, domethënë mos po hymë pak në hak si me bizneset si me bujqit si me të gjithë qytetarët mos po luajmë hajgare me këta njerëz. Po bëjmë raporte, po i joshim ata në thonjëza me thënë me ato shifra që po i qesim në çdo raport edhe me u subvencionuar ose me u paguar, nuk po paguhen asnjëherë. Ne e dimë sa herë e kemi gritur këtë çështjen me asi. A ka me shkuar procedura e njëjtë edhe për këtë raport si raporte të tjera? Kjo është pyetja që.

Anëtar i Komisionit: Faleminderit. Na qysh e thotë rregullorja, ne ja japim kryetarit raportin, raportin e qet në asamble, votohet edhe shkon në komision qëndrorë.

Florent Ukaj: Në AME shkon edhe kjo a?

Anëtar i Komisionit: Jo këtë nuk e di, se këtu e keni lyp ju asambleistët se ne hala se kena pas gati.

Antigona Bytyqi: Po po, shefat e grupeve e kanë propozu.

Florent Ukaj: Neve drejtoresha neve na ka thënë kështu saherë, çdo herë na ka thënë që ne nuk kemi të drejtë me.

Anëtari i Komisionit: po aq është e jonja si komision.

Florent Ukaj: Por po du me thënë si procedurë e njëjtë është.

Anëtari i Komisionit: Po.

Florent Ukaj: Se ne gjithë e kemi votuar edhe për bujqësinë a ka shkuar njëjtë kemi votuar edhe bujqësinë njëjtë.

Anëtari i Komisionit: Ju si asambleista mundeni me ja propozu kryetari me bë pagesë.

Florent Ukaj: Po unë e kam propozuu Urim, po tash ne veç po bëjmë bashkëbisedim pa naj keqkuptim. Çdoherë mu ka dhënë përgjigje negative që nuk kemi drejtë, AME-ja, nuk kemi drejtë AME-ja, pyetja e njëjtë se kemi fol për bujqit.

Anëtari i Komisionit: Puna e komisionit nuk është...

Florent Ukaj: Në rregull, në rregull s'po du me ju thënë juve që ju keni me, ju punën juaj po e kryni.

Anëtari i Komisionit: për vërshimet e para që i kemi bërë, ato janë shku edhe ato kanë vendosur qeveria me i pagu, kanë merr një vendim të kryeministrit, për këto të tjerat nuk ka ndonjë vendim se me siguri shkon...

Florent Ukaj: Jo veç unë desha si procedurë thashë mos mos dallon prej...

Anëtari i Komisionit: Jo jo e njëjta është sipas ligji dhe metodologjisë, por nvaret...

Florent Ukaj: Domethënë e njëjta po e votojnë, nuk ka pas ndonjë kuvendar këtu që ka refuzuar me..

Anëtari i Komisionit: Nëse ka mundësi unë e kam një sugjerim për juve por ndoshta edhe për komunën, komunës me e bë një preventiv na se kjo ka ndodhur po në të ardhmen mos të ketë kësi ngjarje komuna me u organize, se siç e dimë u kanë një pikë shitëse e tash duhet me marrë preventiva ose komuna me e siguru një vend ku lejohet shitja apo ajo.

Florent Ukaj: Ajo është krejt tjetër, shumë e drejtë është.

Anëtari i Komisionit: preventiva është shumë më e mirë se me u marrë me ngjarje, kështu që unë propozoj që ju shitja...

Florent Ukaj: Ajo nuk diskutohet, ne kemi pasur edhe çështje të ngritur para se me ndodh aksidenti.

Karanfil Haxhillari: Ne kemi pas kërkesë në kuvend me u ndaluar komplet sepse.

Anëtari i Komisionit: Ka zgjidhje e bënë një lokasion të caktuar ku mund të shesin ata që kanë qenë, edhe aty të jetë ambulanca, policia.

Florent Ukaj: Përveç asaj me të vërtetë edhe prej këtij rastit po edhe për një mësim që po thu ti për vitet e ardhshme edhe unë pajtoj me Filin që duhet me u ndalu. Unë beso pak para se me ndodhë rasti më ka ranë me komunikue me dikë rastësisht kështu tha në ora 11 të natës vjen dikush i gjuan petardat në korridor të banesës edhe krejt me asi. Domethënë edhe përveç, nuk diskutohet tash që ka ndodhur rasti, por ka dhe raste shumë të tjera që ne nuk po i trajtojmë e që besoj që kërkesa edhe e Filit edhe e krejtve duhet me qenë shumë e arsyeshme që me u ndalu fishekzjarret në komunë, duhet me kanë një mësim i mirë për komunën tone.

Karanfil Haxhillari: Vetë logjika bre kur të importohen a e ke pa qysh importohen këto mjetet shpërthyse, domethënë me automjete të policisë para, nuk lejohen me u ndalë bile këto automjete gjatë importit brenda në Kosovë po pastaj si po hymë në Kosovë.

Antigona Bytyqi: Po Bajram urdhëro.

Bajram Kastrati: faleminderit. Unë pajtohna plotësisht me propozimin e Ademit dhe të parafolësit sa i përket familjes të ndjerit. Desha veç një pyetje, do të thotë për krejt vlerësimin a ka qenë në plotni koordinimi me këta dëmtuesit, po mendoj në bazë të kërkesave të tyre, a e keni bërë vlerësimin në bashkëpunim edhe me ta? Pastaj a e kanë parë vlerësimin ata, a e kanë përkrah atë vlerësim? edhe tjetra ne kemi biseduar edhe herën e kaluar ne s'po mundemi me gjetë, ne po e votojmë mirë respekt për vlerësimin që e keni ba, por na s'po mujmë me gjetë tash edhe hapësirë ligjore qysh me i subvencionu këta. Prapë që tha Lenti, kjo po shkon në AME atje edhe kurr gjë ne po e bëjmë krejt punën tonë edhe në fund kurr gjë. A ka ndonjë hapësirë? e përmende preventivën, a ka ndonjë hapësirë për të ardhmen me u bë ndonjë kod buxhetor paraprakisht për këto, a ka hapësirë ligjore?

Anëtari i Komisionit: Po kodi mundet me u bë me sa unë e marr vesh nëse kryetari, se kryetari ka themeluar këtë komision edhe kryetari mund me nda një buxhet të caktuar për kesi raste besoj.

Urim Krasniqi: Sa i përket atë që tha ti të dëmtuarit secili e nënshkruar procesverbalin, pa prezencë të tij këtu e kemi nënshkrimin.

Bajram Kastrati: Qartë, e tash po i bjen që ne prapë kemi me u taku si grup, si shefa të grupeve ose si përfaqësues të partive me gjetë një formë edhe ne s'mujtëm me gjetë formë, s'kish hapësirë ligjore që ne me i subvencionu si komunë. Tash drejtorja po thotë që s'kemi hapësirë, a duhet me patjetër në të ardhmen me pas një kod buxhetor sa i përket këtyne rasteve? a duhet dikush me propozu këtë kod buxhetor? ju si drejtori a duhet me pas me patjetër? A e hyn veç në atë kategorinë e subvencionimeve.

Ymer Berisha: Nëse bëhet prej subvencioneve mund të bahen prej subvencioneve që i ka kryetar dhe i kanë disa prej drejtorive të caktuara, por duhet me u bartë ato mjete pa zë shpenzues buxhetor, 0 euro guxon kush me prekë. Tash unë po e kam pak problem ky material nëse votohet nga 41 kuvendar edhe veç shkon për AME, pse se le një komunikim të brendshëm që i bjen nuk del atje me i rrit ambiciet ose pritjet e biznesit ose të familjes që tha ky, Nëse kryetari nuk ka pare me nda, atëherë thotë komuna e Prizrenit e ka formuar komisionin edhe e ka çuar vlera është sa është dhe

i shkon AME-së, por nuk bëhet zhurmë me rrit pritjet fictive. E njëjta domethënë veç ju votoni bëni krejt çka i keni.

Bajram Kastrati: Edhe s'kemi asnjë mundësi ne ma.

Ymer Berisha: E dëgjoj unë që biznesi im ka me u kompenzu ishte njëri 60 mijë euro e të tjera këto. Edhe krejt çfarë bënë komuna, qet dokument e qon në AME, AME-ja sa paguan nuk e di. T'i mundesh me i rritë pritjet, atëherë këto sene qohen në komunikimin e brendshëm administrativ që e bën pjesën e vetë komuna, e ka nxjerrë komisionin e ka verifikuar me atë çmimin e tregut qa kanë qenë dëmet edhe i shkon AME-së.

Florent Ukaj: Edhe unë e pajtohem se po e ceki që saherë, ka persona që kanë hy kreditë me i ymyt që kanë me i marrë në fund të vitit paret e sidomos me fatkeqësi në bujqsi. Unë njoh person që ka ardhur më ka thënë ma ka dëshmu që ka hy kredit me qëllimin që kur të dalin paret e subvencionit për fatkeqësi kam me e paguar. Domethënë unë po mendoj që mos po ju hymë në hak se ato po them pak më ma shkurt e shqip, mos po ju hyjmë në hak, njerëzve po i rritim pritshmëritë edhe në fund zero. Nuk po dua, me ju bashkarisht po bisedojmë që çka?

Anëtari i Komisionit: Po du me u bashkëngjit në atë që po thu ti që kanë hy në kredi, ndoshta është gabimi dhe i kryetarit, kur ka dalë në rast aty ndoshta dhe gjendja emocionale që ju ka thënë atyre me ju pagu komuna. Ata e kanë të incizuar kryetarin, se ne jeni në komunikim me ta, kena me padit komunën se na ka thënë kryetari, se ka të drejtë, ta lëshon incizimin.

Bajram Kastrati: A kemi na naj përgjigje, naj projekt që së paku mundemi me bë për të ardhmen naj buxhet që mos me pas na qesi probleme. Pyetja është, a mujmë ne ligjërisht me pas ndonjë projekt konkret sa i përket buxhetit komunal? apo veç me subvencione kjo është pyetja. A mujm na me pas qysh e thashë një kod buxhetor që me i parapri këtyre.

Florent Ukaj: Bajram, ne e mbajmë mend me sa më kujtohet në Qeverisjen e Vetëvendosjes kur janë subvencionuar kompanitë e autobusëve. Domethënë ne a mujna na qysh janë subvencionu kompanitë e autobusave.

Islam Thaqi: Ne e dimë që janë subvencionu shumë biznese, më falni se ndërhyra, realisht janë gjëra të paplanifikuara, janë subvencionuar për shkak se nuk është arritë me u realizuar në disa planifikime buxheti, atëhere me vendim të Kuvendit, me propozim të kryetarit ajo mundet. Mirëpo kur kemi planifikim buxhetor nuk mundesh një, e dyta është kategori që sipas Ligjit të Financave këta e din më mirë që të drejtat nuk janë në këtë drejtim të komunës, ti mundesh me nda po çka në qoftë se nuk ndodh asnjë fatkeqësi, e them kushtimisht nuk ndodh asnjëherë çka bë.

Bajram Kastrati: Ka hapsirë ligjore me bë bartje.

Islam Thaqi: I bartë, por munde me ndodhë ndonjë fatkeqësi që e ka trefishin, e di që në aspektin ligjor nuk është.

Ymer Berisha: Kryesuese a ta jap një propozim?

Antigona Bytyqi: Po urdhëro.

Ymer Berisha: Pika sa po shoh nuk është e kompletuar ligjërisht siç duhet, Drejtori i Ekonomisë dhe Financave duhet me qenë, kryetari edhe nga Komiteti Politik i Financave.

Antigona Bytyqi: Dëgjo, më fal që ndërpreva, që po thua për pikën. Ne jemi mbledhur me shefat e grupeve atë ditë, mbledhjen e kaluar me 27 shkurt, se kjo ka qenë e propozuar edhe mbledhjen tjetër, një diskutim me bë rreth këtij shpërthimi që ka ndodhur nga fishekzjarret, mandej jemi mbledh me shefat e grupeve me gjetë një mënyrë se qysh me bë subvencionimin, normalisht ne s'mundemi me caktu as vlerën as nuk kemi hapësirë ligjore edhe është kërkuar raporti edhe po edhe jemi dakorduar me gjithë shefat e grupeve me ardhë komisioni në kuvend edhe me raportu çka kanë bërë deri aty ku kanë mbërri. Se edhe këta brenda mundësive, këta kanë pas dëshirë edhe me subvencionu familjen edhe këta me i ndihmu bizneset më shumë, por ne i dimë procedurat e secilit komision deri këtu ku kanë arritë. Kështu që i falenderojmë për punën, vullnetin që e keni bë. Kjo pikë është tamam e formuluar qysh kanë kërku shefat e grupeve, vetëm komisioni raport.

Ymer Berisha: Saktë është, por çka prodhon ideja është se çka prodhon qekjo pikë, është një dokument i formalizuar nga...

Karanfil Haxhillari: Votohet raporti i komisionit, pastaj veprimi tjetër duhet të jetë, a po i subvencionojmë, edhe me gjet formën.

Islam Thaqi: Hala s'ka ndodh që me u votu një raport.

Antigona Bytyqi: Jo jo, kjo miratim nuk shkon.

Karanfil Haxhillari: Ose diskutohet raporti dhe në bazë të këtij raporti mirret vendimi me u kompensu, subvencionu.

Florent Ukaj: Ajo tjetër është, por për këtë pike nuk është votim, kjo është veç raportim.

Antigona Bytyqi: Jo jo, këtu jemi dakordu vetëm me marrë vesh na si kuvend, ne këtë e kemi veç sa për informata për me ditë ku jemi.

Fahri Krasniqi: Në bazë të Ligjit për Fatkeqësitë Natyrore dhe vlerësimit të dëmeve që e keni rregullore, ato duhet me u votu në kuvend.

Bajram Kastrati: Duhet me na ardhë si pike e rendit të ditës miratim.

Antigona Bytyqi: E dini ju si drejtori, atëherë kur ju e shihni të arsyeshme për me u votu. Në këtë rast kjo është vetëm na për informim, ju përgatiteni ani për seancën tjetër.

Adem Shabanaj: Nëse është shqyrtim dhe miratim është në rregull.

Arbër Krasniqi: Kjo kompetencë i përket kuvendit, mundet edhe me u votu në kuvend ky raport, nëse e sheh kuvendi që duhet me u votu e me shku në AME mundet me u votu, po nëse vullneti i kuvendarëve është me diskutu qet raport e me bë analizë ska asnjë problem. D.m.th mundet edhe me u votu edhe me u diskutu, varësisht se qysh dëshiron me trajtu kuvendi këtë pikë.

Florent Ukaj: Neve si pikë e rendit të ditës na ka ardhë veç për raportim, nuk na ka ardhur për shqyrtim dhe miratim.

Arbër Krasniqi: Në rregull kjo, pamarr parasysh se qysh është i shenuar në rend të ditës, nëse shkon në kuvend dhe kuvendarët dojnë me votu këtë raport, e votojnë pa problem, munden me votu edhe me shku në AME sepse është kompetencë e kuvendit.

Karanfil Haxhillari: Ideja, po mendoj që ideja më e mirë është me qyr ne me tentu mos me e qu në AME meqënëse janë vetëm 80 e diçka mijë euro edhe me qyr a ka mundësi buxheti i komunës për me e bë këtë kompensim. Nuk e kalon 100 mijëshin. Unë nuk po flas për fatkeqësitë natyrore që aty janë qindra mijëra euro, por për këtu në qoftë se ka hapësirë komuna për me i subvencionu, mos me u marrë me AME edhe mos me i lënë me prit këta.

Antigona Bytyqi: Atëherë paraprakisht është mirë si komision me Drejtorinë e Financave, kryetari, Drejtoria e Financave dhe Komisioni.

Karanfil Haxhillari: komisioni e ka bë punën e vetë, qeky është raporti, qeto janë të dhënat.

Florent Ukaj: Ne e dimë totalin sa është, me pas vullnet politik prej kryetarit nga më së pari, kjo punë kryhet shumë kollaj shkurt e shqip.

Antigona Bytyqi: E kemi në kuvend besoj kryetarin ose nënkryetarin, kërkojmë një përgjigje.

Bajram Kastrati: çka po i bjen tash në seancë, qysh me pas na qet pikë të rendit të ditës? A kemi me pas veç si raport a ka me pas miratim.

Florent Ukaj: Mundemi edhe miratim.

Antigona Bytyqi: Pika e rendit të ditës vjen normal se ne e kemi dërguar qështu njëjtë qysh e keni edhe në KPF. A po flasim pak me radhë për shkak të procesverbalit. Qysh ka ardhë në KPF vjen edhe në kuvend, ka ardhë në fakt se e kemi dërguar edhe materialin në kuvend na për ditën e enjte, e mandej çfarë vendosim, e marrim përgjigje edhe prej kryetarit ose nënkryetarit, Drejtori i Financave besoj është atë ditë, sipas mundësive që i cekëm deri tash a ka mundësi meqë është shuma jo shumë e madhe edhe me pa se çka po bëjmë si komunë apo duhet patjetër me vazhdu me AME. Por ju kisha lutur meqë je zyrtar i Drejtorisë së Financave këtu, me pas një takim me drejtorin me kryetarin nëse ka nevojë edhe komisioni, edhe në mënyrë që ta kemi një përgjigje në kuvend.

Florent Ukaj: Sa e mbaj mend drejtoresha na ka thënë që s'kemi të drejtë, jo në seancë po drejtoresha.

Urim Dakaj: Edhe një sqarim në lidhje me këtë, ju kisha lutur më së shumti të jepni zor këtu se ban vaki edhe AME-ja nuk e pranon si raport, ka me na kthy prapë se ka lyp ekspertisë se ka vdekje këtu, ekspertizë të thellë të policisë, policia s'i jep edhe veç kanë me shku ashtu aty. Kështu që ju kisha lutur juve si kuvendar mus me bë send është këtu me mbajtë.

Bajram Kastrati: Por për rastin e vdekjes the që nuk është e përfshirë në këtë raport.

Anëtari i Komisionit: Jo nu është e përfshinë shkaktar i dëmit i dëmit lyp ekspertizë. E kena pas një takim se kemi telashe me Gornje Lubinje atje, kena pas një takim me ta disa herë, herën e fundit i kallëzuam për këtë tha duhet ekspertiza.

Bajram Kastrati: Atëherë sipas mendimit tim ju si drejtori duhet me ja sugjeruar kryetarit qysh me na sjell neve në kuvend, se neve po na qitni, a e di po bin ne në lajthitje, çka po votojmë, ku po përfundojmë, ata qytetarë janë ardhur edhe në seancë herën e kaluar, prapë kanë me ardhë po besoj tash. Edhe tash ne si përfaqësues të qytetarëve në përgjithësi me ditë me definu, a jeni tu pru një projekt që me votu na me miratu këtë buxhet edhe çka me bë me këtë buxhet, me këto vlerësime. Kryetari duhet me na pru, ju si si ekzekutiv po mendoj me na pru edhe ne me dit tash çka po votojmë, jo ne me dhënë ide të ndryshme dhe në fund jo nuk realizohet kjo ligjërisht.

Ymer Berisha: A kthehemi edhe njëherë në atë pikën e parë Kryesuese? Unë kisha me thënë meqë është dokument i brendshëm, komisioni është i komunës, kryetari është i komunës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa është e komunës të mblidhen këto tre sektor.

Antigona Bytyqi: E propozova veç kështu më herët. Po urdhëro Fahri.

Anëtari i Komisionit: Na ka kemi kërkuar, kemi organizuar dhe një takim me komisionin qëndror për vlerësimet, ata neve na kanë thënë që nëse këto vlerësime vijnë atje edhe nuk është një ekspertizë kush e ka shkaktuar zjarrin, qysh ka ardhur zjarri, ne me këto nuk merremi, edhe kjo është një informacion.

Islam Thaqi: Ata e lypin fajtorin kush e ka shkaktuar zjarrin. nuk mundesh me subvencionu familjen, duhet të jemi të sinqertë karshi ligjit e jo të ndijejmë dhimbshmëri kështu emocionale. DO të thotë veprimet të cilat kanë pru deri te kjo fatkeqësi, janë të gjitha punë të ndieshme, fajtorët janë zinxhiror, edhe në kuptimin e asaj që nga dogana policia, blla blla blla e deri në një polic i thjeshtë në rrugë.

Antigona Bytyqi: Mirë, kështu e lëmë e diskutojmë edhe në kuvend meqë e kemi drejtorin edhe ndoshta deri atë ditë na sillni disa informata më tëhollësishme.

Halil Lika: mirë kishte me qenë me organizu me mundësi nesër takimi të realizohet se me ditë me marrë një vendim.

Islam Thaqi: Nëqoftë se ka kohë kryetari duhet një takim.

Antigona Bytyqi: Po ta kishit kërkuar një takim me kryetarin që sot bile sa jeni këtu.

Karanfil Haxhillari: Ideja, kërkesa për dihet vetëm po...

Halil Lika: Po është nevoja me u taku edhe me diskutu me marrë vendim.

Antigona Bytyqi: Po e hedhi në votim atëherë edhe pikën e gjashtë që t'i rekomandohet të mbledhjes. Prezent shtatë jemi, unanimisht ju falenderoj. Faleminderit shumë edhe juve për prezencën, për raportin që na e keni sjellë edhe për prezantimin që na e bëtë këtu, faleminderit shumë. Kalojmë te pika e shtatë.

Pika e shtatë:

Rporti i punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2024;

Antigona Bytyqi: Zotëri Thaqi, fjala për juve.

Islam Thaqi: Siç e dini dhe ju komiteti përfshin monitorimin e punës të dy drejtorive në kuadër të ekzekutivit komunal. Brenda këtij raporti janë të përfshira takimet që i ka zhvilluar ky komitet, me raport të veçantë për çdonjërin drejtor dhe përsa i përket komitetit ne jemi fokusuar në ta them katër fusha të monitorimit të punës. Meqenëse deri më sot nuk kemi pranuar asnjë ankesë pra si komitet për ndonjë rast apo veprim specifik në kuadër të këtyre drejtorive. Kështu që raportin e kemi fokusuar në katër fusha që janë përmend brenda këtij raporti do të thotë monitorimin e buxhetit me veçanti në investimet kapitale do të thotë projektet e veçanta, subvencionimi që ka ndodhur në kuadër të dy drejtorive edhe numrin e shërbimeve apo cilësinë e tyre. Edhe këtu do të thotë sa i përket shërbimeve nuk janë pranuar ndonjë ankesë. Vlen të theksohet që në kuadër të dy drejtorive për sa i përket investime kapitale janë investime shumë vjeçare, po e marr si shembull shkurtimisht, si ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Ndërtimi i Qendrës të Mjekësisë Familjare në lagjen Tusuz e të tjera. Do të thotë janë projekte që zgjasin nga dy eventualisht tre vjet. Për sa i përket buxhetit, ne kemi shkuar në në shifra totale apo në total edhe për dallim nga vitet e kaluara, të dy drejtoritë pak a shumë e kanë realizimin e buxhetit me masë të kënaqshme apo mos them të shkëlqyer, 92% të realizimit të buxhetit shpresoj që gjatë prezantimit të këtij raporti do të jenë edhe drejtorët. Ndoshta për ndonjë pyetje më të hollësishme sa i përket projekteve specifike që ne i kemi përmendur në raport. Kaq është, s'ka diçka të të veçantë. Brenda raportit veç mungon nga Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale se harrova me cek, do të thotë konkurset, nuk kemi arritë të marrim të dhëna për konkurset në kuadër të Drejtorisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ndërsa në Drejtorinë e Shëndetësisë janë të përfshirë edhe konkurset kur janë mbajtur, e kjo veç është në raport. Kaq kam, diçka tjetër s'kam, material e keni marrë më herët.

Antigona Bytyqi: Faleminderit zotëri Thaqi. Në qoftë se kemi ndonjë pyetje diçka.

Bajram Kastrati: Respekt për punën, tash po e arsyetoj edhe mungesën te komiteti për emërtimin e rrugëve sepse keni pas punë nëpër komitete të tjera.

Islam Thaqi: Aty je ti kryesues.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. Po e hedhim në votim atëherë edhe pikën e shtatë që t'i rekomandohet mbledhjes. Prezent jemi gjashtë, unanimisht, ju faleminderit. Atëherë, edhe kjo pikë i rekomandohet ndedhjes së radhës, faleminderit. Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe shihemi të enjten.

Përfundoi në ora 11:09 minuta.

Kryesuesja e KPF-së
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROPOZIM

Kryetari i Komunës së Prizrenit në bazë nenit 7. paragrafi 3. të Ligjit për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji Nr. 06/L-092, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 50. shkronja (a), të Statutit të Komunës së Prizrenit, merr këtë:

VENDIM PARAPRAK MBI DHËNIEN E PRONËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Prizrenit që të merret Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër ngastrën kadastrale nr.11048-17 ZK Prizren, Organizatës Shoqërore Civile e cila vepron në territorin e Komunës së Prizrenit, me qëllim të përmbushjes së Interesit të Përgjithshëm Publik në kuadër të kompetencave të komunës, Ndërtimin e objektit “Qendra e Autizmit”, i cili do të zhvillojë aktivitete të veçanta dhe do të ju ofrojë shërbime psiko-sociale dhe aktivitete rekreative për personave me autizëm dhe personave tjerë me nevojë.

Neni 2

Ngastra kadastrale që do të epet në shfrytëzim, pranë zyrës së kadastrit, është evidentuar si pronë komunale KK Prizren me nr.11048-17, në sipërfaqe prej 1415 m2 ZK Prizren.

Neni 3

Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim organizatës shoqërore civile, konform këtij Vendimi është arsyeshmëria e Interesit të Përgjithshëm Publik në kuadër të kompetencave të komunës, Ndërtimin e objektit “Qendra e Autizmit”, i cili do të zhvillojë aktivitete të veçanta dhe do të ju ofrojë shërbime psiko-sociale dhe aktivitete rekreative për personave me autizëm dhe personave tjerë me nevojë.

Neni 4

Periudha kohore për dhënien e pronës komunale që epet në shfrytëzim është afatshkurtër dhe atë në periudhën prej 15 viteve.

Prona komunale që do të jepet në shfrytëzim afatshkurtër është në pajtueshmëri me dokumentacionin e planifikimit hapësinor.

Neni 5

Prona Komunale që epet në shfrytëzim afatshkurtër, nuk mund ta ndërron titullarin juridik, pronarin e ngastrës kadastrale mbetet në pronësi të Komunës së Prizrenit dhe si e tillë nuk mund të epet në shfrytëzim personit të tretë nga ana e shfrytëzuesit të zgjedhur si fitues në ankand-nuk mund të tjetërsohet, prona nuk mund të jetë barrë tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë komunale.

Neni 6

Komuna e Prizrenit e ruan të drejtën kurdo herë sipas nevojës me qëllim të realizimit të interesave shoqërore apo publike të bëjë ndryshimin e kontratës me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.

Neni 7

Procedura e dhënies së Pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

Neni 8

Obligohet Zyra e Prokurimit në bashkëpunimin me organet tjera komunale si dhe në bashkëpunim me Komisionin Vlerësues të Ofertave për Dhënie të Pronës Komunale në Shfrytëzim, të zhvillojnë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 06/L-092 dhe Rregullores nr.09/2020.


Neni 9

Kryetari Komunës së Prizrenit pas përfundimit të procedurave të tenderimit nga Komisioni Vlerësues, obligohet që të nënshkruajë kontratën mbi shfrytëzimin e pronës komunale në mes të Komunës dhe fituesit të ankandit, ku do të përcaktohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit e të dyja palëve.

Neni 10

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe konfirmimit të ligjshmërisë së këtij vendimi nga ana e MAPL-së.

KRYETARI I KOMUNËS



Shaqir Totaj





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71813068-11048-17

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	07-942-05-6797-2025
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	14.04.2025 - 15:28
Komuna / Opština / Municipality:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Prizren / Prizren / Prizren
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71813068-11048-17	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Urban	1415	07-942-05/6797/25	15.01.2025	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
PRIZREN			15.01.2025	



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenje parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/Other Land	Jo Pjellorë/Neplodno/Unproductive		1415

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	P.SH.KK PRIZREN	KCID1832139	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN /		TRG.PRIZREN.LIG	1/1		14.04.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRIZREN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prizren

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71813068-11048-17	Parcelë / Parcela / Parcel	1415



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created: Enes

Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____

Shënim/Beleška/Note: _____



Data/ Data/Date: 14.04.2025

Koha/ Vreme/ Time: 03:29:21



PROPOZIM

Kryetari i Komunës së Prizrenit në bazë të nenin 17 dhe nenit 19 paragrafi 1 dhe 2, pika 2.1, të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji Nr. 06/L-092, nenit 17 dhe nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e proceduarve të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe në bazë të nenit 50 të Statutit të Komunës së Prizrenit, merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1

Themelohet Komisioni Vlerësues prej pesë (5) anëtarësh, në përbërje prej dy (2) deputetëve të Kuvendit të Komunës (emrat dhe mbiemrat), dy (2) përfaqësuesve të ekzekutivit të Komunës (emrat dhe mbiemrat) dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, për vlerësimin ekonomik të ofertave pas mbylljes së ankandit, për dhënien e pronës komunale dhe atë ngastrën kadastrale nr.11048-17 ZK Prizren, OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Prizrenit.

Për secilin vendim paraparak të Kuvendit të Komunës për shpalljen e ankandit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale formohet komisioni vlerësues.

Neni 2

Kompetencat e Komisionit do të jenë ato kompetenca të parapara konform dispozitave të neneve të përshkruara më lartë të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) për Përcaktimin e proceduarve për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.


Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Komisionit dhe Njësit përkatëse të Administratës së Komunës që i ofrojnë përkrahje komisionit vlerësues.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe konfirmimit të ligjshmërisë së këtij vendimi nga ana e MAPL-së.

KRYETARI I KOMUNËS


Shaqir Totaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Belediyesi



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren



RAPORTI I REALIZIMIT TË BUXHETIT

PËR PERIUDHËN JANAR –MARS 2025

Prill 2025
Prizren

PËRMBAJTJA

I.	TË HYRAT E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT KOMUNAL	3-4
II.	TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE	5-8
	i. Pasqyra e arkëtimit të të hyrave vetanake gjatë periudhes Janar-Mars 2025	
	ii. Pasqyra e ecurisë së realizimit të të hyrave sipas muajve	
	iii. Pasqyra krahasuese e planifikimit dhe realizimit të të Hyrave Vetanake për periudhën Janar-Mars 2023, 2024,2025	
	iv. Grafiku I të hyrave	
	v. Pasqyra e të hyrave vetanake	9-10
III.	SHPENZIMET E BUXHETIT KOMUNAL	11-14
	A. Shpenzimet e përgjithshme të Buxhetit Komunal	
	i. Shpenzimet në kategorinë e investimeve kapitale sipas drejtorive	
	ii. Pasqyra krahasuese e shpenzimeve të Komunës, sipas kategorive, për periudhën Janar-Mars për vitet 2023, 2024,2025	
	B. Shpenzimet sipas Kategorive dhe Drejtorive:	15-18
	i. Drejtoria e Administratës Komunale	
	ii. Drejtoria Komunale e Shëndetësisë	
	iii. Drejtoria Komunale e Arsimit	
	iv. Drejtoria e Shërbimeve Sociale	
IV.	PASQYRAT E SHPENZIMEVE	19-26
	i. Shpenzimet e përgjithshme sipas Drejtorive dhe Kategorive	
	ii. Raporti Përmbledhës I Kontrollit të Buxhetit-SIMFK	

**TË HYRAT E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT KOMUNAL
PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2025**

Të hyrat	Buxheti i miratuar 2025	Buxheti me ndryshime 2025	Alokimi I-III-2025	Shpenzimet I-III-2025	Buxheti i pashpenzuar I-III-2025	Alokimi i pashpenzuar I-III-2025	Ind. Alok/plan	Ind. Shp./plan	Ind. Shp./Alok.
Granti qeveritar 2025	58,251,699	58,251,699	38,176,772	17,526,473	40,725,225	20,650,299	65.54	30.09	45.91
Të hyrat vetanake 2025	10,600,777	10,600,777	1,015,731	857,673	9,743,104	158,058	9.58	8.09	84.44
Të hyrat vetanake të bartura nga 2024	-	-	-	-	-	-			
Te hyrat nga donacionet e brendshme - participimi	-	168,930	168,930	32,840	136,089	136,089	100.00	19.44	19.44
Donacionet e jashtme	-	42,314	42,314	-	42,314	42,314	100.00	-	-
Financimet nga huamarrjet	1,500,000	1,500,000	1,500,000	-	1,500,000	1,500,000	100.00	-	-
Totali	70,352,476	70,563,720	40,903,747	18,416,987	52,146,733	22,486,760	57.97	26.10	45.03

Në tremujorin e parë të vitit 2025, granti qeveritar është alokuar në shumën prej 38.176.772 €, pra 65.54% e shumës së planifikuar për tërë vitin (58,251,699 €). Shuma e shpenzuar nga ky burim i Buxhetit komunal është 17,526,473€ ose 30.09% e shumës së paraparë për sivjet .

Për periudhën Janar-Mars të vitin 2024 nga granti qeveritar janë alokuar 36.031.474 € kurse janë shpenzuar 13.296.341 € .

Gjatë periudhës Janar- Mars 2025 të hyrat vetanake janë alokuar në shumë prej 1,015,731 € ose 9.58% nga planifikimi prej 10,600,777 €. Nga kjo shumë janë shpenzuar 857,673 € ose 8.09% e shumës së planifikuar.

Në periudhën e njëjtë të vitit 2024 të hyrat vetanake janë alokuar në shumën prej 1,063,398 €. Shpenzimet nga kjo kategori e të hyrave kanë qenë 705,415 € .

Deri në këtë periudhë të raportimit nuk është bërë alkomi i të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak.

Në periudhën Janar-Mars 2024, të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak gjithashtu nuk kanë qenë të alokuara.

Nga të hyrat prej participimit me popullatën në periudhën Janar-Mars 2025 janë alokuar 168,930 €. Shpenzimet nga ky burim kanë qenë 32,840 €.

Në vitin 2024 nga participimi me qytetarë janë alokuar 469,015 €. Shpenzimet nga ky burim kanë qenë 5,200 €.

Gjatë periudhës Janar-Mars të vitit 2025, nga kategoria e të hyrave nga donatorët e jashtëm janë alokuar 42,314 €. Shpenzim nga këto të hyra nuk ka patur.

Në periudhën e njëjtë të vitit paraprak nga donatorët e jashtëm janë alokuar 85,566 € Shpenzim nga këto të hyra gjithashtu nuk ka patur.


Nga Financimi per Huamarrje deri ne fund te muajit Mars janë alokuar 1,500,000 €. Shpenzim nga këto të hyra nuk ka patur.

Financimi nga huamarrja ka rritur shumën e planifikuar të Buxhetit të vitit 2024 për 1,000,000 €. Nga ky burim deri në fund te muajit Mars është alokuar e gjithë shuma.

Të ardhurat totale të alokuara të buxhetit komunal për periudhën Janar-Mars të vitit 2025 janë 40,903,747 € , nga 70,563,720 € të parashikuara, duke u shpenzuar 18,416,987 € ose 26.10% e shumës së planifikuar (70,563,720 €) .

Të hyrat e tërësishme të alokuara në vitin 2024 në shumë prej 38,649,452 €, kanë qenë për (2,254,295)€ më pak se sivjet. Shpenzimi i tërësishëm i buxhetit ka qenë 14,006,956 €.

Pjesëmarrja e mjeteve të alokuara, sipas burimeve, në buxhetin total të Komunës per periudhën Janar –Mars 2025.



**TË HYRAT VETANAKE TË BUXHETIT KOMUNAL
PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2025**

	<i>Planifikimi 2025</i>	<i>%</i>	<i>Realizimi I-III-2025</i>	<i>%</i>	<i>Ind.</i>
<i>Liçensat komerciale dhe të biznesit / Lejet</i>	35,000	0.33	1,698.00	0.09	4.85
<i>Shfrytëzimi i tokës dhe lejet e ndërtimit</i>	2,150,000	20.28	345,558.11	19.24	16.07
<i>Inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike</i>	170,000	1.60	17,229.00	0.96	10.13
<i>Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë</i>	345,000	3.25	124,876.56	6.95	36.20
<i>Shfrytëzimi i pronës Komunale</i>	250,000	2.36	62,323.42	3.47	24.93
<i>Pagesat në lidhje me automjetet</i>	2,020,000	19.06	97,310.07	5.42	4.82
<i>Çertifikatat dhe dokumentet zyrtare</i>	550,000	5.19	80,178.50	4.46	14.58
<i>Tatimi në pronë</i>	3,100,777	29.25	489,855.91	27.28	15.80
<i>Të ardhurat tjera</i>	170,000	1.60	1,668.70	0.09	0.98
<i>Menaxhimi i mbeturinave</i>	1,100,000	10.38	448,744.96	24.99	40.79
<i>Totali i të hyrave vetanake të Adm. Lokale</i>	9,890,777	93.30	1,669,443.23	92.96	16.88
<i>Shendetesia</i>	230,000	2.17	74,536.30	4.15	32.41
<i>Arsimi</i>	470,000	4.43	50,796.00	2.83	10.81
<i>Te hyrat nga Biblioteka</i>	5,000	0.05	418.00	0.02	8.36
<i>Te hyrat nga Teatri</i>	5,000	0.05	627.80	0.03	12.56
<i>Totali i të hyrave vetanake</i>	10,600,777	100.00	1,795,821.33	100.00	16.94

Në tabelën e mësipërme janë dhënë të hyrat vetanake të realizuara për periudhën Janar- Mars 2025 të kategorizuara në bazë të grupeve

Shuma e tërësishme e arkëtuar e të hyrave vetanake komunale për këtë periudhë të raportimit është 1,795,821.33 € ose 16.94 % e shumës së planifikuar prej 10,600,777 € .

Në po të njëjtën periudhë të vitit të kaluar të hyrat vetanake janë arkëtuar në shumë prej 1,880,703 € pra 84,882 € më shumë se sivjet.

Në tabelën e mëposhtme kemi një pasqyrë të realizimit të të hyrave vetanake gjatë periudhës Janar-Mars 2025, sipas drejtorive:

	Planifikimi	Realizimi I-III-2025	%
Administrata dhe Personeli	475,000.00	88,562.21	18.64
Inspekcioni	40,000.00	9,808.70	24.52
Ekonomi, Financa dhe Zhvillim	3,100,777.00	489,855.91	15.80
Sherbimet Publike , Mbrojtja civile, Emergjenca	3,615,000.00	664,313.59	18.38
Kadaster dhe Gjeodezi	470,000.00	61,737.00	13.14
Planifikim Urban dhe Mjedi	2,190,000.00	355,165.82	16.22
Sherbimet e Kujdesit Primar Shendetesor	230,000.00	74,536.30	32.41
Kultura, Rinia dhe Sporti	10,000.00	1,045.80	10.46
Arsim dhe Shkence	470,000.00	50,796.00	10.81
Gjithsej	10,600,777.00	1,795,821.33	16.94


Në shumën e gjithëmbarshme të të hyrave vetanake nuk janë përfshirë të hyrat nga participimi dhe donacioni .

Në tabelën në vijim është dhënë një pasqyrë krahasuese e kategorive të te hyrave vetanake të Komunës, të realizuara për periudhën janar-mars për vitet 2023-2024-2025.


	Planifikimi 2025	Realizimi I-III-2025	%	Planifikimi 2024	Realizimi I-III-2024	%	Planifikimi 2023	Realizimi I-III-2023	%
Licencat komer.dhe të biznesit/Lejet	35,000	1,698.00	4.85	30,000	8,992	29.97	20,000	16,519.78	82.60
Shfryt. i tokes dhe lejet e ndert,	2,150,000	345,558.11	10.13	2,050,000	661,444	19.48	1,500,000	662,220.28	19.22
Inspek. i tokes dhe akt. gjeod.	170,000	17,229.00	36.20	200,000	38,964	29.10	150,000	28,827.00	13.68
Sherb.e inspek.shend. dhe sig.	345,000	124,876.56	24.93	265,000	77,104	25.33	60,000	8,209.07	20.48
Shfrytezimi i prones Komunale	250,000	62,323.42	4.82	175,000	44,330	5.63	100,000	20,475.48	5.62
Pagesat në lidhje me automjetet	2,020,000	97,310.07	14.58	1,600,000	90,090	20.16	1,500,000	84,310.32	26.95
Çertifikatat dhe dok. zyrtare	550,000	80,178.50	15.80	600,000	120,973	15.28	500,000	134,773.50	22.71
Tatimi ne prone	3,100,777	489,855.91	0.98	3,203,294	489,357	0.13	2,423,558	550,269.94	36.30
Te ardhurat tjera Komunale	170,000	1,668.70	40.79	150,000	200	18.95	200,000	72,595.56	26.45
Menaxhimi I mbeturinave	1,100,000	448,744.96	32.41	1,200,000	227,353	29.09	1,200,000	317,359.20	30.30
Te ardhurat nga Sherb. Shend.	230,000	74,536.30	32.41	230,000	66,911	29.09	230,000	69,678.50	30.30
Te ardhurat nga Arsimi	470,000	50,796.00	10.81	470,000	53,448	11.37	470,000	39,400.00	8.38
Te ardhurat nga Sherbimet Sociale							30,000		-
Te hyrat nga Biblioteka	5,000	418.00	8.36	10,000	1,284	12.84	10,000	1,518.00	15.18
Te hyrat nga Teatri	5,000	627.80	12.56	10,000	254	2.54	10,000		
Gjithsej:	10,600,777	1,795,821	16.94	10,193,294	1,880,703	18.45	8,403,558	2,006,157	23.87

Në shumën e gjithëmbarshme të të hyrave vetjake nuk janë përfshirë të hyrat nga participimi dhe donacionet

Ecuria e realizimit të të hyrave sipas muajve:



TË HYRAT E BUXHETIT KOMUNAL





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Të hyrat sipas kategorive

Periudha

